



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1765/2 prot.,

Datë: 24.07.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Amarildo Panda” PF në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-73616-06-26-2023 me objekt “Loti 1, Pjesë këmbimi shërbim mirëmbajtje mjetet” me fond limit 4,102,503 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Ankimues: Operatori ekonomik “Amarildo Panda” SHPK.
Adresa: Fshati Mbrostar Ura, Rruga Fier Kolonjë kilometri i pestë, godina private zona kadastrale 2636, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Maliq
Bulevardi “Rinia”

Në datën 21.07.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1765 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3293 e operatorit ekonomik “Amarildo Panda” PF për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-73616-06-26-2023, me objekt ‘Loti 1, Pjese kembimi sherbim mirembajtje mjetet’ me fond limit: 4,102,503.0 (katër milion e njëqind e dy mijë e pesëqind e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Amarildo Panda” PF.

Bazuar në gërmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Amarildo Panda” PF kundërshton me anë të ankesës me nr. 1765/2023 prot., datë 24.07.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3293.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.2 të përcaktuar në DST pasi nuk ka deklaruar në formularin e shtojcës 8 se ka në dispozicion për kryerjen e shërbimeve një pikë servisi në pronësi ose me qira. Operatori Ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3 të përcaktuar në DST, pasi mungon ne formularin e shtojcës 8 nje inxhinier mekanik dhe një motorrist te nevojshem per realizimin e kesaj procedure prokurimi.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 24.07.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri